

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SOUND FOR FESTIVAL” SH.P.K**

**KREU I**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**  
**EMRI**

1.1 Ne zbatim te ligjit nr. 9901, date 14.4.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te ndryshuar, te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, te ligjit nr. 9121, date 28.7.2003, “Per mbrojtjen e konkurrences”, te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe Kodit te Punës te Republikes se Shqiperise, emerohet shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar, e cila me poshtë do te quhet “Shoqeria” **“SOUND FOR FESTIVAL” Sh.p.k.** Shoqwria eshte themeluar me date 20.06.2023, nga investitori pronari z. Sokol Toska.

1.2 Ne perputhje me ligjin “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” ne kete Shoqeri mund te perfshihen edhe ortake te tjere te cilet behen zoterues te pjesave te caktuara te kapitalit.

**Neni 2**  
**FORMA**

Kjo shoqeri eshte një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

**Neni 3**  
**BAZA JURIDIKE**

Shoqeria Tregtare **“SOUND FOR FESTIVAL” sh.p.k** rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, marredheniet me te punesarit, duke u bazuar ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te ndryshuar, ne ligjin nr. 9121, date 28.7.2003 "Per mbrojtjen e konkurrences", ne Kodin Civil dhe Kodin e Punës te Republikes se Shqiperise dhe ligje te tjera ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 4**  
**SELIA E SHOQERISE**

4.1 Selia e Shoqerise ndodhet në Tiranë, Rr. “Rrapo Hekali”(Kodra e Diellit), P. 23/1.

4.2 Shoqeria ka te drejtë te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranës.

**Neni 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jetë:



- Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, Blerja, shitja dhe marra e dhënia me qira afatshkurtër ose afatgjatë e veglave muzikore, Fonive, bokseve mikrofonave skelave paisjeve ndricuese si dhe mjeteve ndimse te tyre;
- Kompania ofron sisteme audio per Festimet e fundejavave, manifestimet te ndryshme. Per klubet e nates etj.
- Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin.
- Gjithashtu, brenda kufijve te percaktuar nga ligji mund te leshoje garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjeter reale. Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.
- Përvec kesaj ne perputhje me legjisacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet me objektin e mësipërm.

### **Neni 6 KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

6.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pakufizuar. Ky afat fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

6.2 Asambleja Shoqerise mund te vendos kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here, sipas nje vendimi te posacem te marre prej tij.

### **Neni 7 VEPRIMET E LEJUARA TE SHOQERISE**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Asamblea e ortakeve, sipas legjisacionit ne fuqi.

### **KREU II AUTORITETI ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE, KOFIDENCIALITETI**

### **Neni 8 FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT**

Fusha e autoritetit te ortakut tek perqindja e fitimeve ose e humbjeve do te kete si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ortaku ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri te percaktuar ne kete statut.

### **Neni 9 LIBRI I SHOQERISE**

Per te saktesar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredheniet e punes shoqeria do te cele librin e saj i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

### **Neni 10 KOFIDENCIALITETI**

Ortaku i vetem si dhe personat e tjere te pranuar ne Shoqeri bien dakord qe te mos i ekspozojne asnjë personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe, cdo lloj materiali, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

### Neni 11

#### DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria dhe jane te destinuara per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet, publikimet e ndryshme etj., duhet te tregojne lexueshem emrin e Shoqerise si dhe pas saj fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

### KREU III

#### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI

### Neni 12

#### KAPITALI THEMELTAR

12.1. Kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 leke.

12.2. Kapitali themeltar i shoqerise përbëhet nga 1 kuotë me vlerë 100.000 leke.

12.3. Shoqeria mund te shtoje ose zvogeloje kapitalin ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj sipas vendimit te asamblese se ortakeve .

### Neni 13

#### KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues te kesaj Shoqerie **dhe konkretisht Shoqeria : "SOUND FOR FESTIVAL" sh.p.k** me adresë ne TIRANE Tirane, Rr. "Rrapo Hekali"(Kodra e Diellit), P. 23/1 dhe me administrator **Z. Sokol Toska** ne vleren e 100.000 leke

- **Z. Sokol Toska**, i biri i Kadri-ut, lindur me 11.01.1985 ne Mitrovicë dhe banues në 28 North West Ern Avenue, Watford, WD25 0AE Londër, Angli, si ortak i vetëm.

### NENI 14

#### PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise përbëhet nga një kuot e vetme me vleren 100.000 leke.

### Neni 15

#### LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

15.1 Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete ne qofte se ortaku i vetem vendos per kete. Ai mund te lihet peng sipas legjislacionit ne fuqi.

15.2 Gjithashtu kapitali themeltar eshte i transferueshem ne rruge trashegimie.

15.3 Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjezeve te kapitalit themeltar, me vendim te ortakut te vetem dhe sipas kushteve qe lejohen me ligj.

15.4 Transferimet e pjezeve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me një akt themeltar.

**KREU IV**  
**ORGANI I SHOQERISE, KOMPETENCAT, ADMINISTRIMI**

**Neni 16**  
**ASAMBLEA E ORTAKEVE**

Asamblea e ortakeve ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

**Neni 17**

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjeter apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbarë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbarë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çështjet e me poshtme dhe eshte perjegjese per to:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
  - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
  - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarës;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se per gjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja per gjithshme vendos me shumice te zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asamblejamund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50%te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmene votave te ortakeve pjesemarres.
15. Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zgjelimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimitarës së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve te vlefshme behet vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 70% e kuotave janë te pranishem, votojne me shkresë apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendor në kete pikë, të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 18

#### Emërimi i administratorit

1. Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se per gjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

### Neni 19

#### Administrimi

*Koska*

Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar **“SOUND FOR FESTIVAL”** sh.p.k, do te kryhet nga Z. Sokol Toska, i caktuar ne kete detyre per nje periudhe 5-vjecare.

### Neni 20

#### Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

20.1 Të drejtat dhe detyrat e administratorit ose të administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjera që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto të drejta e detyra:

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku i vetem i Shoqerise;
- Te perfaqesoje Shoqerine tregtare;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- Te pergatisi dhc nenshkrue bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, te paraqese keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim;
- Te krijoje një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;
- Te kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrushme te Shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- Te raportoje perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut;
- Te therrasi ortakun e vetem kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

20.2 Ne rast se Asamblea e Ortakeve cakton me shume se nje Administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

20.3 Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### KREU V LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTËT

#### Neni 21

#### LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqeria është e detyruar të mbajë përvëç librit të shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, vendimet e marra nga Asamblea e ortakeve si edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjera.

#### Neni 22

#### BILANCI

- 22.1 Viti finansiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 22.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finansiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen Asamblea e Ortakve me shumice te zakonshme.
- 22.3 Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.

### **Neni 23 DIVIDENTËT**

- 23.1 Asamblea e Ortakve miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit.
- 23.2 Asamblea e Ortakve përcakton fitimin e tij finansiar të cilin i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për:

- rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vetë ortaku;
  - fondet e tjera që shihen të nevojshme; dhe
  - nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme,
- kështu Asamblea e Ortakve përcakton edhe dividentin.

### **KREU VI MBARIMI, LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 24 MBARIMI**

Shoqëria mbaron me vendim të Asamblese se Ortakve ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

#### **Neni 25 LIKUJDIMI**

- 25.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asamblea e Ortakve cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj reportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 25.2 Në fund të procesit të likujdimit, Asamblea e Ortakve vendos mbi bilancin përfundimtar finansiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.
- 25.3 Mbas pagimit të kreditorëve, Asamblea e Ortakve mban pjesën e mbetur të kapitalit dhe e ndan ate sipas pjeseve takuese.

### **KREU VII MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITAT E FUNDIT**

#### **Neni 26 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do ti paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

**Neni 27**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

27.1 Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

27.2 Shoqeria do te kete logon e saj qe perbehet nga fjalet “**SOUND FOR FESTIVAL**”.

27.3 Shoqëria do të ketë vulen e saj, forma edhe madhësia e së cilës do të përcaktohet nga Asamblea e Ortakeve.

Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

**Ortaku**

Shoqeria : **SOUND FOR FESTIVAL** sh.p.k

*SOKOL TOSKA*

**Administrator**

Sokol Toska

*Toska*